

VENDIM
Nr. 212, datë 11.3.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E FINANCIVE, PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR
PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR ICC NR. 20447/MHM S2 ALBANIA SHPK DHE RAPISCAN
SYSTEMS INC. KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 495 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) eurosh, për kryerjen e pagesave të tarifave të avokatëve në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC nr. 20447/MHM S2 Albania sh.p.k. dhe Rapiscan Systems Inc. kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontigjencës, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama